

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**COUNTY NATWEST GUARANTEE COMPANY**

Në bazë të ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në ushtrimin e vullnetit të tij të lirë dhe të plotë, të shprehur në nënshkrimin e aktit të themelimit sot më datë 17 Shtator 2021 personi fizikë si më poshtë i përfaqësuar:

Z. Fabjan Mehmeti, qytetar shqiptar, lindur më 25.03.1978 në Corovod Skrapar, dhe rezidentë në Rruga Pandi Dardha Pallatti 34 shkalla 2 Kt.3 Laprak Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me dokument identifikimi personal, kartë identiteti nr. 035437404 dhe numer personal H80325186Q, e lëshuar më datë 24.12.2019 dhe e vlefshme deri më datë 23.12.2029, nënshkruan statutin si më poshtë vijon:

**NENI 1**

**EMERI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

Emri i shoqërisë është **COUNTY NATWEST GUARANTEE COMPANY SH.P.K.** më poshtë e referuar si shoqëria.

**NENI 2**

**SELIA E SHOQERISE**

Selia e shoqërisë është në Rruga Zonja Curre Nd.31, H.4, Ap.21 Njësia bashkiake nr. 2 Tiranë Shqipëri.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar.

Shoqëria do të marrë personalitet juridik në momentin e regjistrimit të sajë në Qendrën Kombëtare të Bisnesit (QKB) Tiranë.

**NENI 4**

**OBJEKTI I SHOQËRISË**

Shoqëria ka për objekt aktivitetin e kryerjen e të gjitha aktiviteteve të besuara dhe të konsulencës financiare për të cilat nuk janë parashikuar autorizime ligjore specifike. Objekti social mund të zhvillohet në mënyre direkte por edhe indirekte nëpërmjet shoqërive të kontrolluara ose me të njëjtin objekt.

**NENI 5**

**KAPITALI THEMELTARE I SHOQERISE**

Kapitali themeltarë i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetëmijë) Lekë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë.

Kapitali themeltarë i shoqërisë është i përbërë nga kuota që i përkasin ortakëve të renditur si më poshtë:

Oratku Thmelues: Z. Fabjan Mehmeti, qytetar shqiptar, lindur më 25.03.1978 në Corovod Skrapar, dhe rezidentë në Rruga Pandi Dardha Pallatti 34 shkalla 2 Kt.3 Laprak Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me dokument identifikimi personal, kartë identiteti nr. 035437404 dhe numer personal H80325186Q, e lëshuar më datë 24.12.2019 dhe e vlefshme deri më datë 23.12.2029, i cili do të zotërojë 1 (një) kuotë me një vlerë totale prej Lekë 10.000 (dhjetëmijë) e cila do të përbëj 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltarë të shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të zvogëlohet ose mund të rritet dhe është plotësisht i likuiduar dhe i nënshkruar.

#### **NENI 6**

Kapitali i shoqërisë përbehet nga kapitali i saj fillestar, nga pasuri te luajtshme ose te paluajtshme dhe nga te tjera pasuri qe janë dhënë dhe do te jepen te cilat janë te nevojshme për zhvillimin e aktivitetit te shoqërisë.

#### **NENI 7**

Kuotat e kapitalit themeltare do te derdhen nga ortakët ne Banke, ne llogarinë bankare ne emër te shoqërisë dhe derdhjet e kuotave regjistrohen ne librin e llogarive te shoqërisë. Kuotat janë të transferueshme nëpërmjet:

- Shitjes;
- Dhurimit;
- Trashëgimisë.

Në rastë shitje, ortaku që shetë duhet që më përpara ti ofrojë kuotën e vetë ortakëve të tjerë sipas së drejtës së parablerjes. Në rastë se më shumë se një ortak shprehë interesin për të blerë, kuota ndahet midis ortakëve që blejnë në përqindje të barabartë me kuotën e tyre.

Në rastin kur asnjë prej ortakëve ekzistues nuk do që të blejë kuotën e ortakut që del, ky i ofronë në shitje një të treti me detyrimin që përsone i tretë duhet që të marri pranimin e shprehur të ortakëve të tjerë për të blerë kuotën dhe për të bërë pjesë në shoqëri. I njëjti princip përdoret edhe në rastin e trashëgimisë, kur trashëgimtarët nuk kanë interes që të bëjnë pjesë në shoqëri. Ne rastë dhurimi, ortaku që dhuronë duhet që të marri gjithmonë aprovimin e shprehur të ortakëve të tjerë.

Në rastë të kontestimit të vlerës së kuotës në shitje nga ana e ortakëve të tjerë, për përcaktimin e çmimit të shitjes së sajë, emërohet nga ana e asamblesë së përgjithëshme të ortakëve një ekspert i fushës për të vlerësuar ekonomikishtë vlerën rreale të kuotës në basë të çmimit të tregut dhe në basë të vlerave të aseteve të momentit të shoqërisë.

Në rastin kur midis ortakëve lindë një mosmarrveshje për interpretimin e këtij neni, mosmarrëveshja do të zgjidhet në basë të përcaktimeve të nenit 30 të këtij satuti.

#### **NENI 8**

Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakeve te saj. Asambleja e përgjithshme vendos ne baze te ligjit shpërndarjen ose investimin e fitimeve duke vendosur dhe mënyrat.



## **NENI 9**

Shoqëria tregtare, është përdoruese dhe mbajtëse e pasurisë së krijuar. Ajo mund të marrë dhe të ushtrojë të drejtat e tjera, materiale dhe jo materiale, përfshirë dhe të drejtën e shitjes së pasurisë së krijuar të treta.

Ne Republikën e Shqipërisë, shoqëria, gëzon të drejtat e barabarta me çfarëdoq personi tjetër juridik, shqiptar ose të huaj, në bazë të legjislacionit në fuqi.

## **NENI 10**

Shoqëria vepron në regjimin e pronësisë private dhe merr përsipër të gjitha detyrimet dhe të drejtat brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaket marrin përsipër rrezikun e aktivitetit të shoqërisë vetëm brenda limitit të kapitalit themelues të investuar në të.

## **NENI 11**

### **DREJTIMI DHE MENAXHIMI I SHOQËRISË**

Bëjnë pjesë në detyrimet dhe kompetencat e ortakeve, të mbledhur në asamblë të përgjithshme, të gjitha ato që janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe të listuar në këtë statut. Nder këto detyra përfshihen:

- ndryshimi në aktin e themelimit dhe në statut;
- miratimi i buxhetit vjetor, të veprimtarisë së administrimit, të inventarit, të bilancit të llogarisë vjetore;
- emërimi dhe shkarkimi i administratorëve ortake e jo-ortake dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tyre, duke përcaktuar se qofte për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do të jetë e domosdoshme të jepet shprehimisht një shkak;
- miratimin e huave dhe të garancive;
- miratimi i tarifave për shërbimet që kryen shoqëria;
- përcaktimi i formës së vulës dhe të markës së shoqërisë;
- zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
- mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë së shoqërisë;
- miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë së shoqërisë;
- vendimin lidhur me krijimin apo mbylljen e filialeve, përfaqësimeve ose e agjencive të shoqërisë;
- vendimin për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- vendimin për nisjen e një mosmarrëveshje ligjore apo për zgjidhjen e një mosmarrëveshje ligjore në të cilën është e përfshirë shoqëria;
- vendimin për emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe eksperteve kontabël të autorizuar ose konsulentëve të tjerë, persona fizike e juridik;
- vendimin për ndarjen e kotave dhe për anulimin e tyre;
- vendimin për miratimin dhe ndryshimin e rregullave të procedurës për mbledhjen e asamblesë;

- vendimin për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të shoqërisë;
- vendimin për shitjet e kuotave të shoqërisë;
- vendimin për çështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;
- marrjen e çdo vendimi tjetër që nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër;

#### **NENI 12**

Asambleja e Përgjithshme mbledhet si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë edhe jashtë sajë me anë të një njoftimi të dërguar Ortakëve edhe nga ana e njërit prej administratorëve - edhe pa miratimin e Administratorëve të tjerë – me shkrim ose – sipas zgjedhjes së administratorit ose administratorëve – të dërguar me postë elektronike.

Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e duhet t'u dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 dite përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas mënyrës së lartpërmendur, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë këto vendime, pavarësisht nga mungesa e njoftimit për thirrje.

#### **NENI 13**

Vendimet e ortakëve merren me votën në favore të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75% të kapitalit themeltarë në këto raste:

- zmadhimi e kapitalit të shoqërisë;
- ndryshimin e statutit;
- perthithjen dhe bashkimin e shoqërisë;
- modifikimin e emertimit të shoqërisë, të objektit të shoqërisë, transformimin e formës juridike të shoqërisë dhe transformimin e shoqërisë.
- miratimi i bilancit;
- emërimin dhe kohëzgjatjen në detyrë të administratorit ose të administratorëve;
- dhënien e titujve të borxheve, të hipotekave ose të garancive;
- ndarjen e fitimeve.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi, nga një ortak tjetër.

Administratorët e Shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të Ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Në rast se duhet të merren vendime që kërkojnë një shumicë të thjeshtë, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë në Asamble Ortakët me të drejtë vote që posedojnë më shumë se 30% të kuotave.

Në rast se Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështjet që kërkojnë një shumicë të cilësuar sipas nenit. 87 të Ligjit 9901 të vitit 2008, Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme

vetëm nëse Ortaket që mbajnë më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të votave janë të pranishëm personalisht dhe votojnë me shkrim ose me mjete elektronike, në përputhje me dispozitat e pikes 3 të nenit 88 të Ligjit të cituar.

Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit treguar në paragrafin më sipër, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji ose nga statuti për çështje të tjera të listuara në nenin 81 të ligjit 9901 të 2008 nga ato të listuara në nenin e mësipërm, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të thjeshtë me 51% të votave të ortakëve pjesmarrës.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim.

Procesverbali i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorieve, të cilët e regjistrojnë në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të shoqërisë nën kujdesin e Administratorëve.

Vendimet e asamblesë së përgjithshme mund të merren edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### **NENI 14**

Ortakët të cilët nuk marrin pjesë në administrim, kanë të drejtë të ketë nga administratori njoftime për kryerjen e punëve të shoqërisë dhe të konsultohen madje edhe nga ata profesionistë të besuarit e tyre për librat e shoqërisë dhe dokumentet që lidhen me administrimin.

Për të konsultuar librat dhe dokumentet që lidhen me administrimin, që do të kryhen në seline e shoqërisë, ortakët që kanë të drejtë, duhet të bëjnë një kërkesë me shkrim të drejtuar administratorit me letër rekomande së paku tetë ditë para ditës apo ditëve të përzgjedhura (përjashtuar fundjavave dhe festave), duke treguar kohën e aksesit dhe kohën e arsyeshme, orët e tyre të punës, dhe gjithashtu duke specifikuar gjeneralitetet e profesionistit i ngarkuar për të kryer konsultimin

Kostot në lidhje me ushtrimin e të drejtës së inspektimit dhe kontrollit do të jenë në ngarkim të ortakut kërkuar.

#### **DOREHEQJA DHE PERJASHTIMI I ORTAKUT**

##### **NENI 15**

E drejta për të ushtruar dorheqjen nga ana e ortakut për shkaqe të arsyeshme, ushtrohet në bazë të nenit 101 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" nëpërmjet një letre rekomande që duhet të dërgohet ortakëve dhe administratorit të shoqërisë ku shpjegon dhe arsyet e tij të motivuara.

Ortaku mund të dorëhiqet nga shoqëria :

- në rastin kur ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer kundër tij veprime të cilat i kanë shkaktuar një dëm;
- në rastin kur pengohet që të ushtrojë të drejtat e tij;

- ne rastin kur shoqëria ka vendosur për të detyrime të pa arsyeshme;
- për çështje të tjera të cilat e kanë bërë të pamundur veçimin e pjesëmarrjes së tij në shoqëri.

E drejta e dorëheqjes mund të ushtrohet nga ana e ortakut vetëm duke ju referuar të gjithë kuotës së ortakut që jep dorëheqjen.

Ortaku që largohet nga shoqëria ka të drejtë të marrin një rimbursim të kuotës së tij në proporcion me pasurinë e shoqërisë. Kjo pasuri për këtë qëllim përcaktohet duke marrë parasysh vlerën e saj të tregut në momentin e deklarimit të dorëheqjes dhe në veçanti të situatës së pasurisë së shoqërisë, të fillimit të tregtarë, të fitimeve të sajë, të vlerave të mirave materiale dhe jo materiale të poseduara nga ajo, të pozicionit të sajë në treg, dhe të çdo lloji tjetër rrethane ose kushti që normalisht duhet që të mbahet parasysh në përcaktimin e vlerës së kuotës në shoqëri.

Rimbursimi mund të bëhet edhe nepermjete blerjeve nga ana e ortakëve të tjerë në përpjesëtim me kuotën e tyre ose nga ana e një të treti të identifikuar me marrëveshje nga ana e ortakëve.

Në rast mosmarrëveshje për përcaktimin e vlerës së kuotës, ky përcaktim bëhet nga një raport i një eksperti të emëruar sipas mënyrave për shitjen e kuotës të vendosura në këtë statut.

Administratori, duhet që të mbledhë asamblenë menjëherë pas marrjes së diçkaj për njoftimin e dorëheqjes, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota e tij.

Ortaku ka të drejtë që të veprojë në bazë të nenit 30 të këtij statuti për likuidimin e kuotës së vete, si pasojë e dorëheqjes së tij për shkak të arsyeshme, nëse pas njoftimit të dorëheqjes asambleja e përgjithshme nuk mbledhet ose nuk bën si shkak të arsyeshme arsytet e dorëheqjes dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që dorëheqet nga shoqëria është i detyruar që të dëmshpërblejë dëmin e shkaktuar shoqërisë, nëse rezultone që dorëheqja e tij është kryer në bazë të shkaqeve të pa arsyeshme.

#### **NENI 16**

Perjashtimi i ortakut, përveçse rasteve të treguara në nenin 102 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", mund të bëhet edhe për arsye të drejte kur ortakut:

- Për të paktën pesë vjet rresht nuk ka ushtruar asnjë të drejtë në shoqëri;
- Nuk është në gjendje të përmbushë ose ndodhet në pamundësi të përmbushë një punë ose një shërbim;
- Nuk është në gjendje të posedojë të drejtat, ose është i pa aftë ose i ka emëruar një administrator ndihmes;
- Ka qenë i dënuar për një çështje nepermjete së cilës nuk mund të kryej detyra publike edhe perkohësisht;
- A i nënshtrohet procedurës së falimentimit;
- Kryen veprimet e konkurrencës në dëm të shoqërisë, duke përfshirë këtu edhe nepermjete shoqërive apo subjekteve, të administruara nga ai;
- Abuzon me informacionet e marra.

Ne baze te nje vendimi te asamblese se pergjitheshme, shoqeria mund të aplikojë nenin 30 të këtij Statuti për të kërkuar përjashtimin e ortakut per asryet e renditura ne kete nene.

Shoqeria ka te drejte qe ti kerkoje ortakut te përjashtuar zhdëmtimin e demit te shkaktuar nga veprimet qe kan sjelle perjashtimin te renditura me siper.

Ortaku i perjashtuar ka te drejte qe të aplikojë procedurat e nenit 30 të këtij statuti për të kërkuar zhdëmtimin e demit te shkaktuar ne rastin kur kërkesa per përjashtim nuk eshte e bazuar.

Ortaku i perjashtuar ka te drejte qe te kerkoje rimbursimin e kuotes se tije te pjesmarrjes; per kete qellim aplikohet procedura e rimbursimit sic eshte e percaktuar me siper per doreheqjen.

#### **NENI 17**

Ortaku qe përfaqëson te paktën 5 % te totalit te votave ne asamblene e pergjitheshme mund ti drejtohet administratorit me ane te nje kerkese me shkrim, perfshi edhe posten elektronike, per te mbledhur asamblene e pergjitheshme, ose perfshirjen e ceshtjeve te vecanta ne mbledhjen e asamblese se pergjitheshme. Kerkesa duhet qe te permbaje arsytet, objektivat e ceshtjeve qe do te futen ne rendin e dites per tu diskutuar dhe per tu vendosur nga ana e asamblese se pergjitheshme ne baze te nenit 12 te ketij statuti .

#### **NENI 18**

Ne baze te nenit 103 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe Shoqerite Tregtare", te gjitha te drejtat qe rrejdhin nga qenia si ortake ne shoqeri humbin nga data e largimit te tije ose te vendimit te formes se prere te gjykates per doreheqjen ose per perjashtimin e tije.

Ku Statut është redaktuar konform ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe nuk limiton ose përjashton te drejtën e ortakut per doreheqjen e tije dhe te drejten e shoqerise per perjashtimin e ortakut.

#### **NENI 19**

Administratori i shoqerise do te jete Z. Fabjan Mehmeti, qytetar shqiptar, lindur më 25.03.1978 në Corovod Skrapar, dhe rezidentë në Rruga Pandi Dardha Pallatti 34 shkalla 2 Kt.3 Laprak Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me dokument identifikimi personal, kartë identiteti nr. 035437404 dhe numer personal H80325186Q, e lëshuar më datë 24.12.2019 dhe e vlefshme deri më datë 23.12.2029,

Administratori, Z. Fabjan Mehmeti, emërohet per 5 (pes) vjet duke filluar nga data e regjistrimit te shoqërisë ne QKB, me te drejtën për tu rizgjedhur, nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos qe ta shkarkoj atë nga kjo detyre para përfundimit te këtij mandati, ose ne rastin e paraqitjes me përpara te dorëheqjes nga ana e administratorit sipas procedurave te parashikuara nga ligji.

Të gjithë personat ortak ose jo ortak që ushtrojnë detyrën e administratorit do të aplikojnë politikt tregtare të vendosura nga ana e asamblesë së përgjithëshme në bazë të ligjit shqiptar.

Të gjithë personat ortakë ose jo ortakë të cilët ushtrojnë funksionet e administratorit aplikojnë politikat tregtare të vendosura nga ana e asamblesë së përgjithshme konformë ligjit shqiptarë.



Asambleja e përgjithshme mund të emërojë dhe me shumë se një administrator, i cili mund të këtë çfarëdo lloje nënshtetësie. Në rastin e emërimit të një apo me shumë administratorëve në detyrë, të gjithë administratorët do të jenë veç e veç ose bashkërisht përgjegjës për përmbushjen e funksioneve të dhëna administratorit ose administratorëve bashkërisht ose veç e veç nga ana e ligjit, nga Statuti si dhe nga ana e asamblesë së përgjithshme rast pas rasti.

#### **NENI 20**

Administratorët do të jenë veç e veçe ose bashkërisht përgjegjës për përmbushjen e funksioneve të tyre.

Administratorët ushtrojnë ose veç e veçë ose bashkërisht të gjitha kompetencat në lidhje me administrimin e zakonshëm të aktivitetit tregtar të Shoqërisë të pranuar nga ligji në lidhje me administratorët e shoqërive, të tipologjisë në të cilën i përketë kjo Shoqëri, duke marrë – kështu – dokumente dhe vendime të vlefshme nëse përmbajnë nënshkrimin e të gjithë administratorëve ose me nënshkrimin e një prej Administratorëve e shoqëruar me autorizimin me shkrim të të gjithë Administratorëve të tjerë, me përjashtim të aktiviteteve që akti i themelimit dhe/ose Statuti lejojnë shprehimisht që të kryhen nga një Administratorë i vetëm. Administratori kryen detyrat e ngarkuara nga ortakët e shoqërisë në këtë statut dhe të gjitha ato detyra të parashikuara dhe të përcaktuara nga ligji. Midis këtyre detyrave janë të përfshira ato që renditen më poshtë:

- të veprojë dhe të nënshkruajë në emër të shoqërisë;
- të përpunojë rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe një plan biznes për vitin financiar, mi cili do të aprovohet në asamblesë të përgjithshme;
- të përpunojë çdo semestër raportet mbi aktivitetin e shoqërisë dhe të prezantojnë ortakëve;
- të mbajë në rregull regjistrin e vendimeve të asamblesë së përgjithshme;
- administratori janë përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe të tretëve për shkeljet e ligjit ose të normave të statutit që ndodhin gjatë ushtrimit të aktivitetit të vetë, në bazë të ligjit shqiptar;
- të kryej të gjitha aktivitetet e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë, duke aplikuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- të merret me mbajtjen e dokumenteve dhe të librave të llogarive të shoqërisë me korrektesë dhe saktësi;
- të kryejnë regjistrimin dhe të dërgojnë të dhënat e nevojshme të shoqërisë, ashtu siç është parashikuar nga ligji për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- të raportojnë asamblesë së përgjithshme realizimin dhe kryerjen e politikave tregtare dhe për sa i përket realizimit të veprimeve specifike të një rëndësie të veçantë në aktivitetin e shoqërisë tregtare duke menaxhuar me korrektesë dhe vëmendje shoqërinë;
- të kontraktojnë marrëveshje me të tretët në limitet e objektit të aktivitetit të shoqërisë dhe të kompetencave të veta të përcaktuara nga asambleja e ortakëve duke aplikuar në çdo rast rregulloren e brendshme të shoqërisë





- te përgjigjet për demet e sjella shoqërisë nga veprimet
- te paguhet për punën që kryen në baze të marrëveshjeve të bëra me ortakët themelues;
- te informohet dhe të bëjë propozime për çfarëdolloj gjëje që e vlerëson të dobishme për shoqërinë;
- të kryej të gjitha aktivitetet bankare që kanë lidhje me llogarinë e shoqërisë;
- Cdo administratore i vetëm ka të drejtë dhe detyrim për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, në baze dhe duke zbatuar dispozitat e këtij statuti dhe të ligjit;
- Të kryejnë të gjitha detyrat e tjera të dhëna nga ligji dhe Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë të cilat nuk janë përshkruar në mënyrë specifike me sipër.

## **DETYRIMET DHE TË DREJTAT E SHOQËRISË**

### **NENI 21**

Shoqëria ka si më poshtë të drejtat dhe detyrimet e veta:

- të kryejë veprimtari në baze të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë;
- të sigurojë pasurinë e saj;
- të marrë kredi në lekë dhe në valute të huaja nga Bankat vendase ose të huaja në baze të normave ligjore;
- të përfitojë nga favorët që i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera ;
- të investojë kudo në Shqipëri, me të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;
- të punësojë punëtorë, vendas ose të huaja;
- të eksportojë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj;
- të sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;
- të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;
- të sigurojë punonjësit e saj;
- të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktore ndaj cilitdo;
- të respektojë standardet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

### **NENI 22**

#### **RAPORTET EKONOMIKE DHE FINANCIARE TË SHOQËRISË**

Të gjitha aktivitetet e shoqërisë për plotësimin e objektit të saj, pasqyrohen në bilancin ekonomik të saj.

### **NENI 23**

Në selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në baze të cilit, brenda datës 31 Mars të çdo viti nxirret bilanci.

Përveç rasteve kur kjo vendoset me ligj, shoqëria çdo vit përveçese bilancit, duhet që të ngarkoj me detyrë një Ekspert Kontabël, të ndryshëm nga personi ose personat që kanë bërë bilancin, për të kryer një raport audit mbi bilancin.

Asambleja e ortakëve aprovonë më vete raportin e auditimit, përveç rasteve kur kjo parashikohet nga ligji për motiv të arritjes së nivelit të faturimit për të cilin vendoset me ligj për tu kryer një raport auditimi përveçse bilancit dhe aprovimi jepet më vete nga ana e asamblesë për të dyja aktet.

Në rastin kur raporti i auditimit të jashtëm nxjerrë në pahë mospërputhje mbi bilancin secili ortak ka të drejtën që të kërkojë një hetim të thelluar nëpërmjet ekspertëve të vetë të besuar të cilët kanë të drejtë që të kenë mundësinë e shqyrtimit të të gjithë akteve dhe dokumenteve kontabël të shoqërisë.

Në rastin kur mospërputhja konfirmohet përsëri ortakët duhet që të mblidhen në asamble – të thirrur ose nga ana e një prej ortakëve ose nga ana e administratorit – për të zgjidhur këto mospërputhje.

Në rastin kur asambleja nuk mblidhet për herë të dytë, ortaku që ka zbuluar mospërputhjet ka të drejtë që të heqë dorë nga kuota e vetë ose ti drejtohet gjykatës kompetente, për tu ushtruar në bazë të këtij statuti, dhe në rastin kur nuk është e mjaftueshme në bazë të ligjit.

#### **NENI 24**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

#### **NENI 25**

Shoqëria mban një ose më shumë llogari në bankë ose në banka të ndryshme të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë dhe në të gjitha monedhat që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të vet tregtar.

#### **NENI 26**

Nga fitimet e realizuara gjate vitit financiar, shoqëria, pasi bën zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, le mënjanë 5% të fitimit, me të cilin krijohet fondi "Rezerve e domosdoshme", derisa ky fond të arrijë masën 10% të kapitalit themeltar.

#### **NENI 27**

Shoqëria ka vulën e saj dalluese dhe mund të ketë një marke të saj.

#### **NENI 28**

##### **TRASFORMIMI DHE SHPERBERJA E SHOQERISE**

Shndërrimi i shoqërisë, në shoqëri të tipave të tjera, mund të behet me vendim të ortakëve themelues sipas mënyrave të parashikuara nga ligji.

#### **NENI 29**

Shpërbërja e shoqërisë, mund të vije për shkaqet e parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 dhe për arsye të mëposhtme:

- humbja e kapitalit të shoqërisë;
- pamundësi për veprim;
- me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Në këto raste ortakët e shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose më shumë likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen

e pasurisë së shoqërisë deri sa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizike e juridike, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet që ka shoqëria ndaj personave të tretë.

Në rast se fondet të disponueshme, rezultojnë të pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkojë ortakëve themelues të shoqërisë që të derdhin tërësisht kuotat që i takojnë.

### **NENI 30**

#### **PROCEDURA E FILLIMIT TË HETIMEVE, DHE ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE**

Për çdo rast të veçantë e cila shqetëson një ortak, ky i fundit nëpërmjet një njoftimi të kryer ndaj ortakut tjetër brenda 7 ditëve punë, mund të thërres një ekspert të vetin të besuar të fushës specifike i cili ka të drejtën e shqyrtimit të të gjitha akteve dhe dokumenteve të shoqërisë ku ato konservohen. Eksperti duhet që të japi një ekspertizë të kompetencës së vetë – për tu specifikuar në aktin e emërimit nga ana e ortakut ose ortakëve – dhe të qartësoj çështjen. Në rastin kur ekspertiza specifike nxjerrë dhe konfirmon dyshimin e ortakut atëherë ky i fundit, mbledh me urgjencë asamblenë e përgjithshme për të diskutuar në themel dhe për të zgjidhur çështjen që e shqetëson dhe në rastin kur asamblenja e ortakëve për dy herë radhazi, ortakët ka të drejtë që të dali nga shoqëria ose ti drejtohet gjykatës kompetente.

Në rastin kur mosmarrëveshja për tu zgjidhur ose shqetësimi i takon më tepër se një ortak, ose në rastin kur midis ortakëve lindin mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin e këtij statuti, mosmarrëveshja zgjidhet në asamblenë e ortakëve të mbledhur nga ana e ortakut më të vëmendshëm vetëm për këtë qëllim.

Në rastin kur asamblenja e ortakëve, nuk mbledhet për dy herë radhazi, në bazë të këtij statuti edhe nëse ligji, ose në rast të përfundimit negativ të mënyrës me marrëveshje, do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë që do të gjykojë në bazë të ligjit Shqiptarë.

#### **COUNTY NATWEST GUARANTEE COMPANY SH.P.K.**

##### **ORTAKU**

**Fabjan Mehmeti**

